



BE dhe donatorët ndërkombëtarë kontribuojnë me 1.15 miliardë Euro për rindërtimin pas tërmetit në Shqipëri

Brussels, 17 February 2020

Rreth 100 delegacione nga Bashkimi Evropian, Shtetet Anëtare dhe partnerët e tij, përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, u mbledhën sot në Bruksel në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve për të mobilizuar mbështetjen për Shqipërinë pas tërmetit shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019.

Presidentja e Komisionit Evropian **Ursula von der Leyen** duke hapur konferencën tha: *"Sot komuniteti ndërkombëtar u solidarizua me Shqipërinë. Një e treta e kontributit të përgjithshëm vjen nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij, përfshirë Bankën Evropiane të Investimeve. I gjithë Bashkimi Evropian u mobilizua për një vend që është në zemër të kontinentit tonë – dhe që shpresoj dhe jam e bindur se një ditë do të jetë gjithashtu pjesë e Bashkimit tonë. Populli shqiptar e di se i përket familjes sonë evropiane – tani më shumë se kurrë."*

Konferenca u hap nga Presidentja **Von der Leyen**; morën pjesë gjithashtu Kryeministri shqiptar Edi Rama, Presidenti i Këshillit Evropian Charles Michel dhe Kryeministri kroat Andrej Plenković.

Nga totali prej 1.15 miliardë Euro i mobilizuar sot, Bashkimi Evropian, përfshirë Komisionin, Shtetet Anëtare të tij dhe Bankën Evropiane të Investimeve njoftoi 400 milionë Euro për rindërtimin e Shqipërisë. Komisioni Evropian ka premtuar 115 milionë Euro nga buxheti i BE-së. Kjo përfshin një grant të parë prej 15 milionë Eurosh për të rindërtuar dhe rehabilituar ndërtesat kryesore publike siç janë shkollat, nënshkruar sot nga Presidentja **Von der Leyen** dhe Kryeministri Rama, për të mundësuar fillimin e shpejtë të mbështetjes në terren. Komisioni po i bën më tej një propozim Këshillit dhe Parlamentit për një shtesë prej 100 milionë Eurosh në grante nga buxheti i BE-së këtë vit për të mbështetur rehabilitimin dhe rindërtimin e ndërtesave publike dhe private, si dhe rimëkëmbjen e bizneseve të prekura.

Komisioneri për Fqinjësi dhe Zgjerim Olivér **Várhelyi** foli në emër të BE-së në prezantimin e vlerësimit të nevojave pas katastrofës dhe moderoi seancën e premtimit, ndërsa Komisioneri për Menaxhimin e Krizave Janez **Lenarčič** prezantoi reagimin fillestar ndaj emergjencës.

Të dhëna

Më 26 nëntor 2019, një tërmet shkatërrimtar me shkallë magnitude 6.3 Rihter goditi Shqipërinë. 51 persona vdiqën, më shumë se 900 u plagosën, rreth 17.000 u zhvendosën përkohësisht, ndërsa tërmeti preku më shumë se 200.000 persona në 11 bashki. Mijëra ndërtesa u shkatërruan dhe u dëmtuan rëndë, përfshirë infrastrukturën publike dhe private, shtëpi, shkolla dhe struktura të kujdesit shëndetësor.

Ekipet e kërkimit dhe shpëtimit u dislokuan menjëherë në vend pas aktivizimit të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian me kërkesë të qeverisë shqiptare pas tërmetit. Si rezultat, ndihma në natyrë dhe inxhinierët strukturorë u dërguan përmes mekanizmit, si dhe në mënyrë bilaterale, nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe partnerët nga rajoni. Ekipi i Mbrojtjes Civile të BE-së ishte në Shqipëri nga 27 nëntori deri më 20 dhjetor 2019 dhe koordinoi reagimin ndërkombëtar.

Qeveria e Shqipërisë, Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore përgatitën së bashku një raport të vlerësimit të nevojave pas katastrofës, i cili u publikua më 5 shkurt 2020 për të mobilizuar komunitetin e donatorëve. Ai zbulon se ndikimi i përgjithshëm i katastrofës në 11 bashkitë e prekura arrin në mbi 980 milionë Euro dhe se do të duheshin afro 1,08 miliardë Euro për rimëkëmbje në të gjithë sektorët. Shumica e dëmeve të regjistruara janë në sektorin e banesave, ndjekur nga sektori prodhues (si biznesi dhe turizmi, bujqësia dhe trashëgimia kulturore) dhe sektori arsimor.

Për të udhëhequr rindërtimin e sektorit të strehimit, Qeveria e Shqipërisë, Banka e Zhvillimit e Këshillit të Evropës, Banka Evropiane e Investimeve, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore kanë miratuar një sërë parimesh kryesore përmes një Deklarate të Qëllimit. Këto parime ofrojnë parametra për mekanizmat e financimit për të siguruar rindërtim të qartë, efikas, pjesëmarrës dhe transparent,

duke mundësuar përgjegjshmëri dhe koordinim për fondet e kanalizuara dhe kontrollin e përmirësuar të cilësisë së ndërtimeve.

Për më shumë informacion

[Faqja e internetit e Konferencës Ndërkombëtare të Donatorëve "Së bashku për Shqipërinë"](#)

[Deklarata e Qëllimit me rastin e Konferencës Ndërkombëtare të Donatorëve pas tërmetit](#)

[Fjala e hapjes nga Presidentja Ursula von der Leyen në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve "Së bashku për Shqipërinë"](#)

[Komente nga Presidentja Ursula von der Leyen në deklaratën për shtyp me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama](#)

[Komente nga Komisioneri për Fqinjësi dhe Zgjerim Olivér Várhelyi](#)

[Komente nga Komisioneri për Menaxhimin e Krizave Janez Lenarčič](#)

Fotot dhe videot gjenden në [EbS](#)

IP/20/249

Press contacts:

[Eric MAMER](#) (+32 2 299 40 73)

[Dana SPINANT](#) (+32 2 299 01 50)

[Ana PISONERO-HERNANDEZ](#) (+32 2 295 43 20)

[Alceo SMERILLI](#) (+ 32 2 296 48 87)

General public inquiries: [Europe Direct](#) by phone [00 800 67 89 10 11](#) or by [email](#)